



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK
DHE I SPORTIT

BESNIK MORINA & FLORIAN MIFTARI

ANALIZË KRAHASUESE E ZHVILLIMIT MOTORIK DHE
ANTROPOMETRIK TEK FËMIJËT SHTATË DERI NË
NJËMBËDHJETË VJEÇ

MONOGRAFI

MONOGRAFI

ISBN 978-9951-00-375-9



9 789951 003759

Prishtinë, 2025



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK
DHE I SPORTIT**

BESNIK MORINA & FLORIAN MIFTARI

**ANALIZË KRAHASUESE E ZHVILLIMIT MOTORIK DHE
ANTROPOMETRIK TEK FËMIJËT SHTATË DERI NË
NJËMBËDHJETË VJEÇ**

MONOGRAFI

Prishtinë, 2025



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK
DHE I SPORTIT

BESNIK MORINA & FLORIAN MIFTARI

ANALIZË KRAHASUESE E ZHVILLIMIT MOTORIK DHE
ANTROPOMETRIK TEK FËMIJËT SHTATË DERI NË
NJËMBËDHJETË VJEÇ

MONOGRAFI

Prishtinë, 2025

Recenzentë:

Prof. Asst. Dr. Bahri Gjinovci

Prof. Asst. Dr. Malsor Gjonbalaj

Prof. Asst. Dr. Gentiana Beqa Ahmeti

Kryetar i këshillit botues:

Prof. Asoc. Dr. Naim Jerliu

Redaktor profesional:

Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi

Botues:

Universiteti i Prishtinës

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës lejoi publikimin dhe përdorimin
e këtij teksti me vendimin nr. 1/515, të dates 27.06.2025.

DEKLARATË PËR PUNË ORIGJINALE

Me anë të kësaj deklarate, ne, **Prof. Asst. Dr. Besnik Morina & Prof. Asst. Dr. Florian Miftari**, me përgjegjësi, deklarojmë se ky punim nuk është prezantuar për vlerësim apo botuar më parë, pjesërisht apo në tërësi, pranë këtij apo ndonjë institucioni tjetër. Më tej, deklarojmë:

- a) Punimi i paraqitur këtu është origjinal dhe është hartuar në tërësi nga ne;
- b) Punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo nga punime të tjera në Universitetin e Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ ose nga ndonjë universitet tjetër;
- c) Punimi nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo në bibliotekë;
- ç) Punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si kontribut origjinal;
- d) Punimi i respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke i saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burime të tjera.

Ky punim monografie e mban titullin: „Analizë krahasuese e zhvillimit motorik dhe antropometrik tek fëmijët shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç“. Dëshmoj se jemi vënë në dijeni që vërtetimi ndryshe i atyre që u thanë më sipër do të rezultojë me tërheqjen e titullit të fituar bazuar në këtë punim.

Prishtinë, më _____/____/_____

Prof. Asst. Dr. Besnik Morina

Prof. Asst. Dr. Florian Miftari

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	10
2. VLERAT TEORIKE TË HULUMTIMIT	14
3. PROBLEMI, LËNDA DHE OBJEKTIVAT EHULUMTIMIT	15
4. HIPOTEZAT KËRKIMORE	16
5. METODA E PUNËS.....	17
5.1. RRJEDHA DHE PROCEDURAT E HULUMTIMIT	17
5.2. MOSTRA E TË TESTUARVE	17
5.3. MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE	18
5.3.1. MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE MOTORIKE	19
5.3.2. MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE PËR MATJEN E PËRMASAVE ANTROPOMETRIKE.....	19
5.4. PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE.....	20
6. RËNDËSIA E HULUMTIMIT	21
7. QËNDRUESHMËRIA E HULUMTIMIT.....	24
8. INTERPRETIMI I REZULTATEVE	25
9. VERTETIMI I HIPOTEZAVE	68
10. DISKUTIMI.....	70
11. KONKLUDIMI.....	73
12. LITERATURA.....	74

FALENDERIM

Autorët shprehin mirënjohje të thellë ndaj Universitetit të Prishtinës për mbështetjen institucionale dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj zhvillimit të kërkimit shkencor.

Një vlerësim i veçantë i dedikohet anëtarëve të projektit dhe kolegëve nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, të cilët me profesionalizëm dhe përkushtim kontribuan në çdo fazë të realizimit të këtij studimi.

Po ashtu, falënderojmë studentët pjesëmarrës për angazhimin e tyre aktiv, si dhe drejtoritë komunale dhe nxënësit e shkollave fillore të komunave Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan dhe Vushtri, të cilët dëshmuar gatishmëri dhe bashkëpunim të lartë në mbledhjen e të dhënave për monografinë studimore me titull: "*Analizë krahasuese e zhvillimit motorik dhe antropometrik tek fëmijët shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç*". Në fund, shprehim mirënjohje të veçantë për familjet tona, Morina dhe Miftari, për mbështetjen e palëkundur dhe inkurajimin e vazhdueshëm përgjatë gjithë rrugëtimit akademik që kulmoi me realizimin e kësaj monografie.

ABSTRAKTI

Që nga themelimi i saj në vitin 1988, baza e të dhënave EUROFIT është zgjeruar ndjeshëm, duke ofruar mjete të standardizuara për vlerësimin e aftësive fizike te fëmijët. Megjithatë, mungon informacion i mjaftueshëm lidhur me ndikimin e faktorëve mjedisorë në aftësinë fizike të fëmijëve nga mjedise të ndryshme. Ky studim synon të analizojë dallimet e mundshme në performancën e testit EUROFIT ndërmjet fëmijëve meshkuj dhe femra nga zonat urbane dhe rurale të Kosovës, të moshës shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, si dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në këto ndryshime. Mostra përfshinte 1000 nxënës (500 nga zona urbane dhe 500 nga zona rurale), të ndarë sipas moshës dhe gjinisë. Rezultatet treguan se fëmijët urbanë kishin avantazh në fillim të testimeve, për shkak të aksesit më të mirë në aktivitete të organizuara fizike dhe dieta që, ndonëse jo gjithmonë të shëndetshme, kontribuojnë në zhvillimin e fuqisë. Nga ana tjetër, mjedisi rural rezultoi më i favorshëm për zhvillimin e aftësive motorike te djemtë, sidomos gjatë fazës para-pubertare. Për të ruajtur balancën në zhvillimin motorik dhe funksional, rekomandohet që fëmijët urbanë të angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete fizike gjatë gjithë periudhës shkollore. Ndërkohë, tiparet morfologjike mes fëmijëve ruralë dhe urbanë priren të barazohen me afrimin në pubertet. Ky hulumtim kontribuon në plotësimin e bazës së të dhënave EUROFIT për fëmijët nga zona të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Fjalë kyçe: Eurofit, aftësi fizike, djem, vajza, morfologjia

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 - tatistikat përshkruese për grupin e vajzave shtatëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	25
Tabela 2 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve shtatëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	26
Tabela 3 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave tetëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	27
Tabela 4 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve tetëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	28
Tabela 5 Statistikat përshkruese për grupin e vajzave nëntëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	29
Tabela 6 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve nëntëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	30
Tabela 7 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave dhjetëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	31
Tabela 8 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve dhjetëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	32
Tabela 9 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave njëmbëdhjetëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	33
Tabela 10 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve njëmbëdhjetëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.....	34
Tabela 11 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave shtatëvjeçare nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	35
Tabela 12 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve shtatëvjeçarë nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	36
Tabela 13 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave tetëvjeçare nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	37
Tabela 14 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve tetëvjeçarë nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	39
Tabela 15 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave nëntëvjeçare nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	40

Tabela 16 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve nëntëvjeçarë nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	41
Tabela 17 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave dhjetëvjeçare nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	43
Tabela 18 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve dhjetëvjeçarë nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	44
Tabela 19 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave njëmbëdhjetëvjeçare nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	45
Tabela 20 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve njëmbëdhjetëvjeçarë nga zona rurale, për variablat antropometrike dhe motorike.....	47
Tabela 21 - Dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve shtatëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.....	49
Tabela 22 - Dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave shtatëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.....	50
Tabela 23 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve tetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.....	51
Tabela 24 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave tetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.....	52
Tabela 25 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve nëntëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.....	53
Tabela 26 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave nëntëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.....	55
Tabela 27 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve dhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.....	56
Tabela 28 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave dhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.....	57

Tabela 29 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve nëntëmbëdhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.....	58
Tabela 30 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave njëmbëdhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.....	59
Tabela 31 - Dallimi i variancës së dimensioneve antropometrike të trupit tek nxënësit djem të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.....	61
Tabela 32 - Dallimi i variancës së testeve motorike tek nxënësit djem të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.....	63
Tabela 33 - Dallimi i variancës së dimensioneve antropometrike të trupit tek nxënëset vajza të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.....	64
Tabela 34 - Dallimi i variancës së testeve motorike tek nxënëset vajza të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.....	66

1. HYRJJE

Zhvillimi i një gjendjeje të mirë shëndetësore gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës lidhet ngushtë me nivelin e aftësive motorike, të cilat përfaqësojnë një komponent thelbësor në rritjen dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve (Myers et al., 2002). Aktiviteti fizik konsiderohet një faktor kyç për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe mendor (Dencker & Andersen, 2008), ndërkohë që përhapja e mbipeshës dhe obezitetit në këtë grupmoshë shoqërohet me një rrezik të shtuar për zhvillimin e sëmundjeve kronike që mund të zgjasin gjatë gjithë jetës.

Kolegji Amerikan i Mjekësisë Sportive (ACSM, 2018) rekomandon që fëmijët të angazhohen çdo ditë për të paktën 60 minuta në aktivitetet fizik të organizuar, brenda ose jashtë ambienteve shkollore (Biddle, 1998). Kjo përfshirje është e domosdoshme për zhvillimin normal të funksioneve trupore dhe të aftësive motorike. Përveç kësaj, matja dhe vlerësimi i efekteve të aktiviteteve fizike kërkon përdorimin e instrumenteve të standardizuara, si bateria e testimit EUROFIT (Adam, 1988), e cila përdoret gjerësisht në vendet e Bashkimit Evropian për fëmijë dhe adoleshentë.

Gjithashtu, matja e parametrave antropometrikë mundëson monitorimin e rritjes dhe zhvillimit trupor, si dhe vlerësimin e dallimeve në përmbajtjen trupore sipas gjinisë dhe moshës. Vlerësimi i kombinuar i aftësive motorike dhe parametrave antropometrikë ofron një panoramë të plotë të procesit të rritjes së fëmijëve në zona të ndryshme gjeografike, si ato urbane dhe rurale.

Ky studim është motivuar nga mungesa e të dhënave të standardizuara në Republikën e Kosovës që lidhen me zhvillimin motorik dhe morfologjik të fëmijëve. Kjo mungesë përbën një pengesë serioze në vlerësimin real të gjendjes së tyre fizike dhe në efikasitetin e programeve të edukimit fizik. Duke përfshirë një numër të madh nxënësish dhe duke realizuar krahasime ndërmjet zonave urbane dhe rurale, ky hulumtim synon të kontribuojë në krijimin e një baze të qëndrueshme të të dhënave dhe një sistemi unik për matjen e dimensioneve antropometrike dhe aftësive motorike të nxënësve në nivel shtetëror.

2. VLERAT TEORIKE TË HULUMTIMIT

Parakushti bazë për zhvillimin normal të fëmijëve dhe të rinjve është angazhimi i tyre në aktivitete fizike dhe sportive. Qëllimi ynë kryesor si mësimdhënës është të ruajmë dhe përmirësojmë shëndetin e fëmijëve përmes përfshirjes së tyre në aktivitete fizike. Jemi të bindur se orët e edukatës fizike në shkolla dhe aktivitetet sportive luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi. Moshë shkollorë përfaqëson një periudhë të favorshme për krijimin e shprehive të aktivitetit fizik, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht gjatë gjithë jetës.

Nga kjo rrjedh se përgjegjësia për ruajtjen e shëndetit dhe zhvillimit fizik të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për përmirësimin e aftësive të tyre motorike, duhet të ndahet ndërmjet pedagogëve të edukatës fizike dhe profesionistëve të shëndetësisë. Rritja dhe zhvillimi fizik i fëmijëve, së bashku me progresin e tyre motorik, duhet të maten, vlerësohen, monitorohen dhe korrigjohen përmes procesit të mësimdhënies dhe trajnimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në moshën parashkollorë, kur trupi i fëmijëve është më i ndjeshëm ndaj ndikimeve të jashtme, efektet e të cilave mund të shfaqen më vonë dhe që shpeshherë janë të vështira për t'u korrigjuar në një fazë të mëvonshme të jetës (Popović, 2008).

Një qasje e drejtë ndaj çdo hulumtimi nënkupton ndërtimin paraprak të një modeli teorik, të bazuar në përvojat e mëparshme dhe në studimet përkatëse të temës, si dhe formulimin e hipotezave adekuate (Madić, 2000). Hapësira antropologjike përbën një strukturë shumëdimensionale dhe ndërvepruese. Në këtë kontekst, ky punim synon të analizojë modelet teorike të nënhapësirave përkatëse - përkatësisht karakteristikat antropometrike dhe statusin motorik - të cilat kanë një rol thelbësor në ruajtjen e shëndetit dhe ndikojnë ndjeshëm në performancën fizike të nxënësve dhe sportistëve në disiplina të ndryshme sportive

3. PROBLEMI, LËNDA DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Problemi i këtij hulumtimi - respektivisht i kësaj monografie - ka qenë të analizojë gjendjen aktuale të aftësive motorike dhe të krahasojë përmasat antropometrike të trupit të nxënësve të shkollave fillore në zonat urbane dhe rurale të Republikës së Kosovës.

Subjekt i hulumtimit kanë qenë nxënësit e shkallës së parë dhe të dytë të ciklit fillor (klasat 1, 2, 3, 4 dhe 5), sipas kurrikulës së Kosovës, përfshirë djem dhe vajza nga zona urbane dhe rurale, me fokus në karakteristikat e tyre antropometrike dhe aftësitë motorike.

Në përputhje me temën dhe problemin e përcaktuar të hulumtimit, janë formuluar qëllimi kryesor dhe objektivat dytësore të studimit.

Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë të përcaktohet nëse ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit dhe në disa nga aftësitë motorike të fëmijët e moshës shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, në varësi të moshës, gjinisë dhe zonës së banimit (urbane apo rurale).

Identifikimi i këtyre dallimeve është me rëndësi praktike për aplikimin e tyre në procesin e mësimdhënies. Vlerësimi i diferencave domethënëse në karakteristikat antropometrike dhe në aftësitë motorike do t'u mundësonte mësimdhënësve dhe profesionistëve arsimorë të planifikojnë dhe programojnë më mirë zhvillimin e karakteristikave antropologjike të nxënësve në shkollat fillore.

Në përputhje me qëllimin kryesor janë përcaktuar edhe këto qëllime specifike të hulumtimit:

1. Të përcaktohet nëse ekziston një ndryshim statistikisht i rëndësishëm në dimensionet antropometrike të trupit të djemve të moshës 7-11 vjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.
2. Të përcaktohet nëse ekziston një ndryshim statistikisht i rëndësishëm në dimensionet antropometrike të trupit të vajzave të moshës 7-11 vjeçare nga zonat urbane dhe rurale.
3. Të përcaktohet nëse ekziston një ndryshim statistikisht i rëndësishëm në aftësitë motorike të djemve të moshës 7-11 vjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.
4. Të përcaktohet nëse ekziston një ndryshim statistikisht i rëndësishëm në aftësitë motorike të vajzave të moshës 7-11 vjeçare nga zonat urbane dhe rurale.

4. HIPOTEZAT KËRKIMORE

Bazuar në temën dhe problemet e hulumtimit, si dhe duke u mbështetur në qëllimin e studimit dhe përvojat nga hulumtimet e mëparshme, janë formuluar hipotezat kërkimore në vijim:

H1: Pritet të ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit të djemtë e moshës 7-11 vjeçarë, nxënës të shkollave fillore, nga zonat urbane dhe rurale.

H2: Pritet të ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit të vajzat e moshës 7-11 vjeçare, nxënëse të shkollave fillore, nga zonat urbane dhe rurale.

H3: Pritet të ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në aftësitë motorike të djemtë e moshës 7-11 vjeçarë, nxënës të shkollave fillore, nga zonat urbane dhe rurale.

H4: Pritet të ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në aftësitë motorike të vajzat e moshës 7-11 vjeçare, nxënëse të shkollave fillore, nga zonat urbane dhe rurale.

5. METODA E PUNËS

Hulumtimi është realizuar me një mostër prej 1000 nxënësish të testuar (20 grupe). Nga ta, 500 nxënës kanë qenë nga zonat urbane dhe 500 nxënës nga zonat rurale, të moshës 7, 8, 9, 10 dhe 11 vjeçar, të ndarë sipas gjinisë (djem dhe vajza). Pjesëmarrësit janë trajtuar në përputhje me Deklaratën e Helsinkit. Projekti është zhvilluar gjatë periudhës mars 2023 - shkurt 2024, në ambientet standarde të shkollave, gjatë orëve të rregullta të edukimit fizik dhe sporteve. Matjet janë kryer nga profesionistë - profesorë dhe studentë të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit - të cilët paraprakisht janë trajnuar për procedurat e matjes dhe testimit. Pjesëmarrësve iu kërkua zyrtarisht që të merrnin pjesë në studim përmes kanaleve të komunikimit të institucionit, ndërsa prindërve të tyre iu kërkua të jepnin pëlqimin me shkrim. Ky projekt është miratuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, me numër protokollit 677, datë 24.03.2023. Hulumtimi është kryer në përputhje me parimet e Deklaratës së Helsinkit.

5.1 RRJEDHA DHE PROCEDURAT E HULUMTIMIT

Rrjedha dhe procedura e hulumtimit është përbërë nga gjashtë faza, duke përfshirë periudhën mars 2023 - shkurt 2024.

Zhvillimi i projektit:

1. Faza e parë (mars-prill 2023): Identifikimi i mostrës për testim dhe matje;
2. Faza e dytë (prill-qershor 2023): Realizimi i matjeve dhe grumbullimi i të dhënave;
3. Faza e tretë (qershor-korrik 2023): Futja e rezultateve në kompjuter;
4. Faza e katërt (korrik-gusht 2023): Përpunimi i rezultateve;
5. Faza e pestë (gusht-tetor 2023): Interpretimi i rezultateve;
6. Faza e gjashtë (tetor 2023 - prill 2025): Përmbyllja e projektit, e cila përfshin publikimin e artikujve në revista shkencore, përgatitjen e monografisë, si dhe prezantimin në ngjarje të rëndësishme sportive, konferenca ose simpoziume.

5.2 MOSTRA E TË TESTUARVE

Ky hulumtim është realizuar mbi një mostër nxënësish (djem dhe vajza) nga shkollat fillore në zonat urbane dhe rurale të Republikës së Kosovës, të moshës 7, 8, 9, 10 dhe 11 vjeçar. Kampioni i përgjithshëm ka

përfshirë 1000 nxënës të testuar, prej të cilëve 500 djem dhe 500 vajza. Mostra është ndarë në nën-mostrat e mëposhtme:

- Nën-mostra e moshës 7 vjeçar: 100 nxënës (djem dhe vajza) nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale;
- Nën-mostra e moshës 8 vjeçar: 100 nxënës (djem dhe vajza) nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale;
- Nën-mostra e moshës 9 vjeçar: 100 nxënës (djem dhe vajza) nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale;
- Nën-mostra e moshës 10 vjeçar: 100 nxënës (djem dhe vajza) nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale;
- Nën-mostra e moshës 11 vjeçar: 100 nxënës (djem dhe vajza) nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale;

Mostra ka përfshirë nxënës nga shkolla të ndryshme fillore në zonat urbane dhe rurale. Përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë të rastësishme, bazuar në një kampion të thjeshtë të rastit.

Të gjithë pjesëmarrësit janë testuar në mënyrë vullnetare.

5.3 MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE

Për vlerësimin e nivelit të aftësive motorike të nxënësit, janë zgjedhur teste që konsiderohen me rëndësi parësore për matjen e këtyre aftësive. Gjithashtu, janë përdorur teste që matin nivelin e funksionit kardiorespirator, si testi i qëndrueshmërisë në vrapim me vajtje-ardhje (Beep Test), si dhe teste që vlerësojnë aftësitë motorike, përfshirë: forcën statike, forcën shpërthyesë, forcën muskulore, forcën e trungut, shpejtësinë, ekuilibrin e trupit dhe matjet antropometrike. Këto të fundit përfshijnë: dimensionet gjatësore të trupit, vëllimin trupor dhe indin dhjamor nënlëkuror.

Është përdorur një bateri testesh të standardizuara, e zhvilluar nga Këshilli i Evropës për fëmijët e shkollave fillore, e cila është zbatuar në shumë matje me nxënës të shkollave të ndryshme evropiane që nga viti 1988. Në përputhje me objektivat e këtij hulumtimi, janë shtuar edhe disa instrumente shtesë matëse, me interes specifik për kërkimin tonë shkencor. Numri i përgjithshëm i instrumenteve të përdorura ka qenë pesëmbëdhjetë.

5.3.1 MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE MOTORIKE

Aftësitë motorike janë vlerësuar përmes baterisë së testeve EUROFIT. Kjo bateri testesh (C. Klissouras, V. Ravazzolo, M. Renson, & W. Tuxworth, 1988) përdoret gjerësisht tek fëmijët dhe adoleshentët në shumicën e vendeve evropiane për të vlerësuar aftësitë motorike të tyre.

Fusha e vlerësimit përfshin tetë instrumente matëse, të cilat janë si më poshtë:

- Për vlerësimin e ekuilibrit të trupit:
 1. Testi i balancimit “Flamingo” (MBF)
- Për vlerësimin e shpejtësisë së frekuencës së lëvizjes së duarve:
 2. Testi i taping-ut me dorë (MTD)
- Për vlerësimin e fleksibilitetit:
 3. Testi i përkuljes në bankë ulur (MPBU)
- Për vlerësimin e forcës eksplozive:
 4. Kërcimi së gjati nga vendi (MKGJV)
- Për vlerësimin e forcës së muskujve të barkut:
 5. Ngritja në pozitë ulur (MNPU)
- Për vlerësimin e forcës statike të krahëve dhe brezit të shpatullave:
 6. Qëndrimi i varur në hekur (MQVH)
- Për vlerësimin e shpejtësisë:
 7. Vrapimi 10 x 5 metra (MV10X5)
- Për vlerësimin e sistemit kardio-respirator:
 8. Vrapimi me vajtje-ardhje (Beep test) (MVVA)

5.3.2 MOSTRA E INSTRUMENTEVE MATËSE PËR MATJEN E PËRMASAVE ANTROPOMETRIKE

Matjet e përmasave antropometrike të trupit janë kryer sipas Programit Ndërkombëtar Biologjik (International Biological Programme - IBP). Sipas këtij programi ekzistojnë 39 masa lineare, por për qëllimet e këtij hulumtimi janë përdorur shtatë (7) prej tyre.

Për të vlerësuar dimensionet antropometrike të trupit janë përdorur instrumentet matëse të mëposhtme:

- Për matjen e dimensioneve gjatësore (longitudinale):
 1. Lartësia e trupit në këmbë (ALTK)
 2. Lartësia e trungut ulur (ALTU)
 3. Gjerësia e krahëve të hapur (AHKH)
- Për matjen e indit dhjamor nënlëkuror:
 4. Indi dhjamor i tricepsit (AIDHT)
 5. Indi dhjamor i shpinës (AIDHSH)
 6. Indi dhjamor i barkut (AIDHB)
- Për matjen e peshës trupore:
 7. Pesha trupore (APT)

5.4 PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE

Nisur nga problemi, si dhe përcaktimi i qëllimit dhe vendosja e hipotezave, në këtë hulumtim kemi përdorur parametrat themelorë statistikore si:

1. Mesatarja aritmetike (Mesatarja)
2. Devijimi standard (Std. Dev)
3. Rezultati minimal dhe maksimal (Min, Max)
4. Koeficienti i asimetrisë së shpërndarjes së rezultateve (Skewness)
5. Koeficienti i lakimit të shpërndarjes së rezultateve (Kurtosis)
6. Analiza e variancës
7. T-testin
8. F-testin
9. Testin Chi-square për të testuar rëndësinë diskriminuese

Rezultatet e marra nga testimi në zonat e hulumtuara janë përpunuar me paketën statistikore SPSS, versioni 20.0.

6 RËNDËSIA E HULUMTIMIT

Rëndësia e këtij hulumtimi vlerësohet në dritën e mungesës së studimeve të ngjashme në Kosovë. Deri më tani, ekziston një numër i kufizuar punimesh që trajtojnë çështje të ngjashme, dhe ato që janë në dispozicion ofrojnë një qasje të pjesshme në shpjegimin e temës në fjalë. Shumica e studimeve të mëparshme janë përqendruar vetëm në aspekte të caktuara të aftësive motorike ose përmasave morfologjike, apo në marrëdhëniet ndërmjet tyre, por asnjëra nuk ka ofruar një analizë gjithëpërfshirëse të nivelit të aftësisë fizike. Veçanërisht mungon një krahasim dinamik i gjendjes së aftësive fizike midis brezave të ndryshëm. Përfshirja në këtë studim e një numri të madh nxënësish nga të dyja gjinitë, si dhe qasja gjithëpërfshirëse e trajtimit të temës, përbëjnë një kontribut të rëndësishëm dhe një risinë në kontekstin e kërkimeve të deritanishme në Kosovë në këtë kategori popullore.

Ky hulumtim është i rëndësishëm për disa arsye:

- Rezultatet e marra do të ofrojnë një pasqyrë të qartë të situatës aktuale sa i përket peshës trupore të nxënësve të moshave të testuara, për të dy gjinitë, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Nëpërmjet të dhënave të mbledhura do të konstatohet nëse ka dallime statistikiqisht të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit dhe në nivelin e aftësive motorike të nxënësve të shkollave fillore, në varësi të moshës dhe gjinisë.
- Do të ofrojë të dhëna të vlefshme për dallimet ekzistuese midis zonave urbane dhe rurale në lidhje me karakteristikat e testuara, duke pasuruar kështu bazën e njohurive në këtë fushë.
- Do të prezantojë një qasje të re kërkimore, veçanërisht në mënyrën e trajtimit të problematikave që lidhen me edukimin fizik, dhe që deri tani janë hulumtuar pjesërisht ose në mënyrë fragmentare në Kosovë.
- Do të shërbejë si një bazë solide për vendosjen e standardeve në nivel kombëtar, duke mundësuar krahasimin e rezultateve me ato të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

PËRSHKRUANI ROLIN E SECILIT ANËTAR TË EKIPIT

Kontributi dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit janë paraqitur si më poshtë:

- Prof. Asst. Dr. Besnik Morina - Udhëheqës i projektit shkencor; përgjegjës për planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha fazave të hulumtimit.
- Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 7-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Prof. Asst. Dr. Malsor Gjonbalaj - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 8-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Prof. Asst. Dr. Florian Miftari - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 9-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Prof. Asst. Dr. Bahri Gjinovci - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 10-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Prof. Asst. Dr. Gentiana Beqa-Ahmeti - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 11-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Dr. Sc. Gani Ibrahim - Anëtar i projektit; drejtues i ekipit për matje dhe testime të fëmijëve 11-vjeçarë; përgjegjës për organizimin dhe realizimin e matjeve në këtë grupmoshë.
- Dr. Ass. Armend Kastrati - Anëtar i ekipit për matje dhe testime; ndihmon në realizimin praktik të mbledhjes së të dhënave.
- Dr. Ass. Liridon Bekolli - Anëtar i ekipit për matje dhe testime; mbështet në aspektin metodologjik dhe teknik të realizimit të testimeve.
- Adisa Hoxha - Studente në nivelin Master; pjesë aktive e ekipit për matje dhe testime; angazhohet në mbledhjen dhe organizimin e të dhënave.
- Jehona Zeka - Studente në nivelin Master; kontribuon në realizimin e matjeve dhe testimeve në terren.
- Agonita Fazliu - Studente në nivelin Bachelor; pjesë e ekipit për matje dhe testime; ndihmon në procesin e mbledhjes së të dhënave.
- Muhamed Rashica - Student në nivelin Bachelor; angazhohet në mbledhjen dhe organizimin e të dhënave gjatë testimeve.
- Arbnor Azemi - Student në nivelin Bachelor; pjesë e ekipit të matjeve dhe testimeve; ndihmon në realizimin praktik të punës.

- Arton Ahmeti - Student në nivelin Bachelor; kontribuon në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe zbatimit të testimeve.

**MËNYREN E BOTIMIT TË REZULTATEVE TË HULUMTIMIT
(ARTIKUJ NË REVISTA SHKENCORE, MONOGRAFI, NGJARJE
TË RËNDËSISHME ARTISTIKE DHE SPORTIVE,
KONFERENCA OSE SIMPOZIUME).**

Rezultatet e marra nga ky projekt janë publikuar në platformën Skopus dhe Web of Science.

Referencat e publikimeve:

Morina, B., Nikqi, V., Krasniqi, R., Babić, M., Vlahović, T., Preljević, A., Žigman, M., & Sporiš, G. (2024). Age-stratified EUROFIT scores and differences of rural and urban male children in Kosovo. *Pedagogy of Physical Culture and Sports*, 28(4), 301–308.

<https://doi.org/10.15561/26649837.2024.0407>.

Gjinovci, B., Morina, B., Sporiš, G., Nikqi, V., Akman, O., Jurko, D., Osmani, A., Grle, M., Grle, I., Prlić, J., & Citozi, R. (2025). EUROFIT Reference Values of 7-11 Aged Children in Urban Areas of Kosovo: Relations between Age and Gender. *Sport Mont*, 23(1), 73-78. doi: 10.26773/smj.250211.

<http://www.sportmont.ucg.ac.me/?sekcija=article&artid=2086>.

7. QËNDRUESHMËRIA E HULUMTIMIT

Qëndrueshmëria e kësaj monografie, përkatësisht e projektit shkencor, është e garantuar përmes disa komponentëve thelbësorë që sigurojnë vazhdimësinë dhe ndikimin e tij afatgjatë në fushën e edukimit fizik, shëndetit publik dhe kërkimit shkencor në Kosovë.

1. Potenciali për monitorim afatgjatë: Ky projekt është konceptuar në mënyrë që të shërbejë si bazë për studime të vazhdueshme longitudinale, duke mundësuar ndjekjen e të njëjtave grupmosha gjatë viteve të ardhshme. Kjo e bën të mundur analizimin e zhvillimit trupor dhe motorik në mënyrë dinamike dhe sistematike.
2. Ndikimi në politikëbërje dhe standardizim: Të dhënat e mbledhura dhe analizat përkatëse ofrojnë një bazë të besueshme për hartimin e standardeve kombëtare të vlerësimit të gjendjes fizike dhe shëndetësore te fëmijët e moshës shkollore. Rezultatet e projektit mund të përdoren për të përmirësuar programet mësimore të edukimit fizik dhe politikat shëndetësore për fëmijë.
3. Përdorshmëria e rezultateve nga studiues dhe institucione: Përfshirja e një numri të madh të nxënësve, ndarja sipas gjinisë, moshës dhe zonës gjeografike (urbane/rurale), e bën këtë projekt një pikë referimi të rëndësishme për studiues të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Të dhënat mund të shërbejnë për krahasime rajonale dhe ndërkombëtare.
4. Përfshirja e studentëve dhe stafit akademik: Pjesëmarrja aktive e studentëve të nivelit bachelor dhe master, si dhe e stafit akademik të FEFS-it, rrit kapacitetet kërkimore të universitetit dhe siguron përgatitjen e brezave të rinj të studiuesve. Kjo ndihmon në ndërtimin e një baze të qëndrueshme shkencore brenda institucionit.
5. Infrastrukturë dhe bashkëpunim institucional: Përdorimi i pajisjeve ekzistuese, përkrahja institucionale nga FEFS dhe ZKPS-UP, si dhe mungesa e varësisë nga financime të jashtme, dëshmojnë se projekti ka potencial për të vazhduar edhe në të ardhmen me burime minimale.
6. Aplikueshmëria në fusha të tjera: Rezultatet dhe metodologjia e përdorur mund të zbatohen edhe në grupe të tjera moshe apo kategori të ndryshme të popullsisë, duke rritur kështu aplikueshmërinë praktike dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të projektit.

8. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Tabela 1 - statistikat përshkruese për grupin e vajzave shtatëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	16.00	32.70	24.94	0.66	4.69	-0.17	-1.04
AGJT	108.00	142.00	124.14	0.93	6.55	-0.38	0.59
BMI	10.93	27.09	16.17	0.41	2.89	0.98	2.68
AGJTU	60.00	74.00	68.26	0.48	3.37	-0.53	-0.41
AGJDH	103.00	135.00	119.86	1.01	7.15	-0.77	0.17
AIDHT	3.00	16.00	9.24	0.50	3.53	0.29	-0.86
AIDHB	3.00	15.00	7.78	0.49	3.46	0.55	-0.51
AIDHSH	3.00	13.00	6.28	0.34	2.39	0.72	0.18
MBF	4.00	40.00	17.50	1.64	11.57	0.94	-0.18
MTD	12.18	24.20	17.22	0.44	3.10	0.44	-0.55
MPBU	20.00	57.00	43.20	1.35	9.53	-0.95	0.30
MKV	55.00	111.00	88.24	2.15	15.20	-0.11	-0.68
MNPU	6.00	17.00	10.82	0.40	2.80	0.69	0.04
MQVH	0.00	39.11	6.75	1.26	8.93	2.00	4.71
MV10X5	20.16	28.55	22.57	0.20	1.41	1.42	5.68
MVVA	1.50	5.10	2.77	0.11	0.79	0.46	0.36

Tabela 1 tregon se pesha trupore e grupit të vajzave shtatëvjeçare luhetet nga 16.00 kg në minimum deri në 32.70 kg në maksimum. Gjatësia trupore varion nga 108.00 cm minimale deri në 142.00 cm maksimale. Indeksi i masës trupore (BMI) ka vlera nga 10.94 në minimum deri në 27.09 në maksimum. Gjatësia e trungut ulur është nga 60.00 cm në nivelin minimal deri në 74.00 cm në nivelin maksimal. Gjatësia e duarve të hapura varion nga 103.00 cm në minimum deri në 135.00 cm në maksimum. Indeksi i dhjavit nën lëkurë, matur te tricepsi, është nga 3.00 mm në minimum deri në 16.00 mm në maksimum. Indeksi i dhjavit nën lëkurë në bark ka vlerat minimale 3.00 mm dhe maksimale 15.00 mm, ndërsa ai i dhjavit nën lëkurë në shpinë varion nga 3.00 mm deri në 13.00 mm. Në testin e ekuilibrit, numri minimal i gabimeve është 4, ndërsa maksimalja arrin në 40. Koha minimale e realizuar për taping me dorë është 12.18 sekonda, dhe koha maksimale është 24.20 sekonda. Fleksibiliteti shtrihet nga 20.00 cm në nivelin minimal deri në 57.00 cm në atë maksimal. Kërcimi nga vendi ka një diapazon nga 55.00 cm deri në 111.00 cm. Numri minimal i ngritjeve të muskujve të barkut gjatë 30 sekondave është 6, ndërsa maksimal është

17. Qëndrimi i varur në hekur varion nga 0.00 sekonda deri në 39.11 sekonda. Në vrapimin 10x5 metra, koha minimale është 20.16 sekonda, ndërsa koha maksimale arrin në 28.55 sekonda. Në Beep testin 20 metra, niveli më i ulët i arritur është 1.50, ndërsa ai më i larti është 5.10.

Tabela 2 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve shtatëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	19.00	46.70	25.13	0.80	5.67	2.37	6.92
AGJT	115.00	137.00	124.94	0.74	5.24	0.09	-0.43
BMI	12.22	31.38	16.09	0.49	3.43	2.55	8.41
AGJTU	61.00	75.00	68.44	0.45	3.16	-0.11	-0.31
AGJDH	108.00	137.00	122.92	0.91	6.44	-0.06	-0.31
AIDHT	4.00	21.00	8.90	0.50	3.56	1.43	2.96
AIDHB	3.00	25.00	6.88	0.69	4.91	2.33	5.10
AIDHSH	3.00	16.00	5.44	0.35	2.48	2.55	8.14
MBF	1.00	40.00	17.06	1.65	11.63	0.82	-0.24
MTD	14.88	30.00	20.00	0.47	3.31	0.81	1.61
MPBU	24.00	48.00	36.10	0.84	5.93	-0.30	-0.82
MKV	68.00	151.00	102.78	2.83	20.03	0.13	-0.06
MNPU	7.00	22.00	14.48	0.47	3.33	0.21	0.17
MQVH	0.00	35.40	8.11	1.14	8.06	0.94	1.08
MV10X5	19.00	24.68	21.38	0.18	1.26	0.21	-0.28
MVVA	1.50	5.40	3.08	0.24	1.69	4.82	28.92

Tabela 2 tregon se pesha trupore e grupit të djemve shtatëvjeçarë varion nga 19.00 kg në minimum deri në 46.70 kg në maksimum. Gjatësia trupore është nga 115.00 cm minimale deri në 137.00 cm maksimale. Indeksi i masës trupore (BMI) luhetet nga 12.22 në minimum deri në 31.38 në maksimum. Gjatësia e trungut ulur është nga 61.00 cm në nivelin minimal deri në 75.00 cm në atë maksimal. Gjatësia e duarve të hapura varion nga 108.00 cm deri në 137.00 cm. Indeksi i dhjavit nën lëkurë te tricepsi është nga 3.00 mm deri në 21.00 mm. Indeksi i dhjavit nën lëkurë i barkut varion nga 3.00 mm deri në 23.00 mm. Indeksi i dhjavit nën lëkurë i shpinës luhetet nga 3.00 mm në minimum deri në 16.00 mm në maksimum. Në testin e ekuilibrit, numri minimal i gabimeve është 1, ndërsa ai maksimal arrin në 40. Koha minimale për taping me dorë është 14.88 sekonda, ndërsa koha maksimale arrin në 30.00 sekonda. Fleksibiliteti matet nga 24.00 cm

në nivelin më të ulët deri në 48.00 cm në nivelin më të lartë. Kërcimi nga vendi shtrihet nga 68.00 cm deri në 151.00 cm. Numri minimal i ngritjeve të muskujve të barkut në 30 sekonda është 7, ndërsa maksimal është 22. Qëndrimi i varur në hekur varion nga 0.00 sekonda deri në 35.48 sekonda. Në vrapimin 10x5 metra, koha minimale është 19.00 sekonda, ndërsa koha maksimale është 26.68 sekonda. Në Beep testin 20 metra, niveli minimal i arritur është 1.50, ndërsa ai maksimal është 5.40.

Tabela 3 - Statistikat përshkruese për grupin e vajzave tetëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	20.00	75.00	27.92	1.24	8.78	3.61	16.97
AGJT	119.00	158.00	130.10	0.93	6.58	1.53	5.71
BMI	12.02	30.04	16.26	0.46	3.23	2.28	6.79
AGJTU	65.00	85.00	70.94	0.49	3.47	1.58	4.80
AGJDH	115.00	150.00	125.06	0.99	7.03	1.02	1.95
AIDHT	5.00	19.00	8.60	0.51	3.63	1.68	2.79
AIDHB	3.00	26.00	6.70	0.69	4.87	2.55	6.53
AIDHSH	3.00	20.00	5.82	0.52	3.67	2.33	5.44
MBF	1.00	40.00	17.72	1.73	12.20	1.00	-0.29
MTD	11.98	22.65	17.02	0.36	2.55	0.09	-0.17
MPBU	21.00	50.00	37.02	0.96	6.79	-0.22	-0.56
MKV	55.00	130.00	93.18	2.51	17.75	0.06	-0.10
MNPU	0.00	22.00	12.30	0.84	5.95	-0.78	-0.24
MQVH	0.00	60.00	13.49	1.73	12.21	1.47	3.23
MV10X5	19.08	28.72	21.47	0.24	1.70	1.65	6.01
MVVA	1.40	4.70	2.99	0.12	0.86	0.14	-0.75

Tabela 3 tregon se pesha trupore e grupit të vajzave tetëvjeçare varion nga 20.00 kg në minimum deri në 75.00 kg në maksimum. Gjatësia trupore është nga 119.00 cm në nivelin minimal deri në 158.00 cm në atë maksimal. Indeksi i masës trupore (BMI) luhetet nga 12.02 deri në 30.04. Gjatësia e trungut ulur matet nga 65.00 cm deri në 85.00 cm. Gjatësia e duarve të shtrira varion nga 115.00 cm në minimum deri në 150.00 cm në maksimum. Indi dhjamor nën lëkurë te tricepsi ka vlerat nga 5.00 mm deri në 19.00 mm. Indi dhjamor nën lëkurë i barkut varion nga 3.00 mm deri në 26.00 mm. Indi dhjamor nën lëkurë i shpinës nga 3.00 mm deri në 20.00 mm. Në testin e ekuilibrit, numri i gabimeve luhetet nga 1 deri në 40. Koha

për taping me dorë varion nga 11.98 deri në 22.65 sekonda. Fleksibiliteti matet nga 21.00 cm në nivelin më të ulët deri në 58.00 cm në nivelin më të lartë. Kërcimi nga vendi shtrihet nga 55.00 cm deri në 130.00 cm. Numri minimal i ngritjeve të muskujve të barkut gjatë 30 sekondave është 0, ndërsa maksimal është 22. Qëndrimi i varur në hekur zgjat nga 0.00 sekonda deri në 60.00 sekonda. Koha për vrapimin 10x5 metra varion nga 19.08 deri në 28.72 sekonda. Në testin Beep për vrapimin 20 metra, niveli minimal i arritur është 1.40, ndërsa ai maksimal është 4.70.

Tabela 4 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve tetëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	21.40	55.90	28.68	1.07	7.54	1.85	3.35
AGJT	120.00	151.00	131.16	0.82	5.81	0.97	1.98
BMI	13.27	25.10	16.50	0.44	3.14	1.51	1.37
AGJTU	65.00	80.00	70.98	0.45	3.19	0.59	0.38
AGJDH	116.00	149.00	126.88	0.92	6.53	0.65	1.46
AIDHT	4.00	16.00	8.78	0.44	3.10	0.46	-0.22
AIDHB	3.00	26.00	7.02	0.77	5.42	2.19	4.35
AIDHSH	3.00	25.00	5.84	0.54	3.82	3.37	13.47
MBF	1.00	40.00	20.42	1.93	13.67	0.40	-1.21
MTD	13.71	26.45	18.07	0.36	2.53	0.65	1.44
MPBU	13.00	49.00	35.74	0.98	6.95	-0.38	1.20
MKV	64.00	140.00	100.72	2.79	19.72	-0.24	-0.90
MNPU	4.00	20.00	12.96	0.52	3.65	-0.05	-0.48
MQVH	0.00	60.00	15.29	2.24	15.87	1.10	0.77
MV10X5	19.20	27.00	21.61	0.24	1.68	1.48	2.74
MVVA	1.60	4.00	3.29	0.44	3.13	6.10	40.79

Tabela 4 paraqet rezultatet minimale dhe maksimale të masave antropometrike dhe disa aftësive motorike tek djemtë tetëvjeçarë. Peshat trupore varion nga 21.40 kg deri në 55.90 kg, ndërsa gjatësi trupore nga 120 cm deri në 151 cm. Indeksi i masës trupore (BMI) luhet nga 13.27 deri në 25.10. Gjatësia e trungut ulur është midis 65 dhe 80 cm, ndërsa hapja e duarve nga 116 cm deri në 149 cm. Sa i përket masave të indi dhjamor nën lëkurë, vlerat për tricepsin janë nga 4 mm deri në 16 mm, për barkun nga 3 mm deri në 26 mm, dhe për shpinën nga 3 mm deri në 25 mm.

Në aspektin e aftësive motorike, numri i gabimeve në testin e ekuilibrit varion nga 1 deri në 40. Koha për taping me dorë matet nga 13.71 deri në 26.45 sekonda, ndërsa fleksibiliteti shtrihet nga 13 cm deri në 49 cm. Kërcimi nga vendi ka vlera që luhaten nga 64 cm deri në 140 cm, ndërsa numri i ngritjeve të muskujve të barkut në 30 sekonda është midis 4 dhe 20. Koha e qëndrimit të varur në hekur varion nga 0 deri në 60 sekonda. Në testin e shpejtësisë 10x5 metra, rezultatet janë nga 19 deri në 27 sekonda, ndërsa në testin e qëndrueshmërisë (20 m Beep test) niveli i arritur varion nga 1.60 deri në 4.00.

Tabela 5 Statistikat përshkruese për grupin e vajzave nëntëvjeçare nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	22.30	56.40	32.30	1.26	8.91	1.39	1.08
AGJT	118.00	149.00	136.26	0.96	6.81	-0.57	0.36
BMI	10.99	32.37	17.34	0.61	4.29	1.48	2.34
AGJTU	65.00	74.00	87.22	13.39	94.71	7.05	49.83
AGJDH	113.00	145.00	131.44	0.98	6.96	-0.45	-0.05
AIDHT	3.00	19.00	9.70	0.51	3.63	0.85	0.29
AIDHB	2.00	19.00	8.04	0.66	4.68	0.96	-0.19
AIDHSH	3.00	15.00	6.40	0.44	3.08	1.23	0.59
MBF	1.00	40.00	11.58	1.52	10.75	1.80	2.65
MTD	11.84	19.59	15.48	0.32	2.24	0.01	-1.27
MPBU	20.00	52.00	39.40	1.09	7.72	-0.14	-0.35
MKV	70.00	148.00	110.48	2.21	15.61	0.00	0.02
MNPU	0.00	22.00	10.78	0.54	3.79	0.15	1.55
MQVH	0.00	60.00	10.27	1.83	12.93	2.34	6.62
MV10X5	19.22	24.24	21.41	0.17	1.19	0.53	0.21
MVVA	1.50	4.50	2.64	0.09	0.61	0.83	1.33

Tabela 5 paraqet të dhënat për grupin e vajzave në moshën nëntëvjeçare, lidhur me parametrat antropometrikë dhe aftësitë motorike. Peshat trupore varion nga 22.30 kg deri në 56.40 kg, ndërsa gjatësi trupore shtrihet nga 118.00 cm deri në 149.00 cm. Indeksi i masës trupore (BMI) luhaten nga 10.99 deri në 32.37. Gjatësia e trungut ulur matet nga 65.00 cm deri në 74.00 cm, ndërsa gjatësia e krahëve të shtrirë është nga 113.00 cm deri në 145.00 cm. Indi dhjamor nën lëkurë në zonën e tricepsit varion nga 3.00 mm deri në 19.00 mm, në bark nga 2.00 mm deri në 19.00 mm, dhe në

shpinë nga 3.00 mm deri në 15.00 mm. Në testin e ekuilibrit, numri i gabimeve është nga 1 deri në 40. Koha për taping me dorë luhet nga 11.84 deri në 19.59 sekonda, ndërsa fleksibiliteti nga 20.00 cm deri në 52.00 cm. Kërcimi nga vendi ka vlera që variojnë nga 70.00 cm deri në 148.00 cm. Numri i ngritjeve të muskujve të barkut gjatë 30 sekondave varion nga 0 deri në 22, ndërsa qëndrimi i varur në hekur nga 0.00 deri në 60.00 sekonda. Koha për vrapimin 10x5 metra luhet nga 19.22 deri në 24.24 sekonda, ndërsa në testin Beep për 20 metra, niveli i arritur varion nga 1.50 deri në 4.50.

Tabela 6 - Statistikat përshkruese për grupin e djemve nëntëvjeçarë nga zona urbane, për variablat antropometrike dhe motorike.

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APT	23.50	61.90	36.26	1.46	10.33	0.79	-0.34
AGJT	123.00	153.00	138.64	0.91	6.45	0.36	0.11
BMI	10.60	30.27	18.80	0.69	4.87	0.68	-0.40
AGJTU	67.00	81.00	76.88	1.92	13.59	4.46	21.13
AGJDH	116.00	152.00	134.18	0.99	7.02	0.07	0.55
AIDHT	4.00	21.00	9.58	0.70	4.95	1.00	-0.18
AIDHB	3.00	45.00	11.00	1.36	9.59	1.71	2.59
AIDHSH	3.00	19.00	6.46	0.59	4.17	1.49	1.43
MBF	2.00	40.00	16.38	1.80	12.71	0.97	-0.41
MTD	10.58	19.62	14.72	0.26	1.84	0.10	0.11
MPBU	9.00	52.00	33.90	1.12	7.93	-0.18	1.13
MKV	39.00	152.00	113.62	4.04	28.53	-1.25	1.27
MNPU	0.00	22.00	12.78	0.75	5.33	-0.65	0.24
MQVH	0.00	60.00	11.57	1.76	12.47	1.62	3.54
MV10X5	17.56	26.27	20.37	0.27	1.89	1.28	1.60
MVVA	1.70	6.50	3.27	0.17	1.19	1.07	0.89

Tabela 6 paraqet të dhënat për grupin e djemve nëntëvjeçarë, lidhur me parametrat antropometrikë dhe aftësitë motorike. Peshat trupore varion nga 23.50 kg deri në 61.90 kg, ndërsa gjatësi trupore shtrihet nga 123.00 cm deri në 153.00 cm. Indeksi i masës trupore (BMI) luhet nga 10.60 deri në 30.27. Gjatësia e trungut ulur është nga 67.00 cm deri në 81.00 cm, ndërsa gjatësi e krahëve të shtrirë varion nga 116.00 cm deri në 152.00 cm. Indi dhjamor nën lëkurë në zonën e tricepsit varion nga 4.00 mm deri në 21.00 mm, në bark nga 3.00 mm deri në 45.00 mm, dhe në shpinë nga 3.00 mm

MPBU	0.07	0.80	1.44	0.15	2.12
MKV	2.95	0.09	-1.05	0.30	-4.55

MNPU	0.01	0.93	1.39	0.17	1.06
MQVH	5.72	0.02	1.37	0.17	3.75
MV10X5	1.37	0.24	3.96	0.00	1.23
MVVA	2.21	0.14	0.42	0.68	0.19

Tabela 23 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet djemve tetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale të gjinisë mashkullore. Nga analiza e vlerave të testit t, testit F dhe probabiliteteve përkatëse, janë evidentuar dallime të rëndësishme në tre tregues antropometrikë ndërmjet djemve nga zonat urbane dhe rurale. Konkretisht, pesha trupore dhe lartësia trupore tregojnë dallime statistikisht të rëndësishme, me vlera të testit t përkatësisht 3.04 dhe 1.95, që janë sinjifikante në nivele besueshmërie prej 99% dhe 95%. Këto rezultate tregojnë se djemtë nga zonat urbane kanë morfologji më të zhvilluar (përmasa trupore më të mëdha) krahasuar me ata nga zonat rurale. Gjithashtu, gjatësia e trungut ulur paraqet një dallim shumë të rëndësishëm statistikisht, me një probabilitet nën 0.01. Në aspektin e aftësive motorike, djemtë nga zonat urbane kanë treguar performancë më të mirë në testin e ekuilibrit (vlera e testit t 3.13) dhe në testin e vrapimit 10x5 metra (probabilitet 0.00), krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat rurale. Variabilitet i madh i rezultateve është vërejtur në testin e qëndrimit në hekur, ku diferencat në variancë brenda grupeve janë të theksuara.

Tabela 24 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave tetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test					
Variablat antropometrike	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference
Mosha = 8 vjeçare, Gjinia = Vajza					
APT	0.58	0.45	1.66	0.10	2.48
AGJT	0.08	0.77	2.61	0.01	3.36
BMI	2.34	0.13	1.10	0.27	0.61
AGJTU	2.48	0.12	1.14	0.26	1.00
AGJDH	0.11	0.74	0.71	0.48	0.96
AIDHT	0.99	0.32	-1.11	0.27	-0.88

AIDHB	6.09	0.02	-3.06	0.00	-4.14
AIDHSH	0.01	0.92	-1.11	0.27	-0.78
MBF	5.05	0.03	1.82	0.07	3.88
MTD	1.16	0.28	-1.37	0.17	-0.79
MPBU	6.83	0.01	-0.64	0.52	-0.78
MKV	0.04	0.83	0.57	0.57	2.04
MNPU	5.48	0.02	0.63	0.53	0.66
MQVH	0.14	0.71	0.75	0.46	2.05
MV10X5	0.54	0.47	-0.46	0.65	-0.18
MVVA	0.13	0.72	0.80	0.42	0.14

Tabela 24 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave tetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale të gjinisë femërore. Nga analiza e vlerave të testit t, testit F dhe probabiliteteve përkatëse, nuk janë evidentuar dallime të rëndësishme në shumicën e parametrave antropometrike ndërmjet vajzave nga zonat urbane dhe rurale. Vetëm indeksi i indit dhjamor në bark ka treguar një dallim të sinjifikant në mesatare, me vlerë të testit t -3.06, duke treguar se vajzat nga zona urbane kanë vlera më të larta të këtij parametri krahasuar me ato nga zonat rurale.

Sa i përket aftësive motorike, janë evidentuar dallime të rëndësishme në variancën e rezultateve për testet e fleksibilitetit të muskujve të ekstremiteteve të poshtme, ku vlera e testit F është 6.83 me probabilitet 0.01. Gjithashtu, testi që mat forcën e muskujve të barkut ka treguar ndryshime të rëndësishme në variancë, me vlerë të testit F 5.48, duke reflektuar ndryshime të dallueshme brenda dhe ndërmjet grupeve.

Tabela 25 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet djemve nëntëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test					
Variablat antropometrike Mosha = 9 vjeçarë, Gjinia = Djem	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference
APT	8.07	0.01	3.11	0.00	5.78
AGJT	0.00	0.95	2.54	0.01	3.24
BMI	17.00	0.00	2.92	0.00	2.36

AGJTU	3.54	0.06	2.05	0.04	4.10
AGJDH	1.03	0.31	0.53	0.60	0.80
AIDHT	1.05	0.31	-0.08	0.94	-0.08
AIDHB	0.04	0.85	-0.81	0.42	-1.58
AIDHSH	0.00	0.98	-0.70	0.49	-0.72
MBF	8.19	0.01	1.85	0.07	4.08
MTD	2.33	0.13	-0.93	0.36	-0.38
MPBU	1.86	0.18	0.74	0.46	1.28
MKV	3.66	0.06	-0.62	0.54	-3.18
MNPU	2.99	0.09	-2.61	0.01	-2.48
MQVH	1.37	0.24	-0.03	0.98	-0.06
MV10X5	0.45	0.51	2.48	0.01	0.89
MVVA	4.67	0.03	-2.11	0.04	-0.64

Tabela 25 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve në moshë nëntëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale të gjinisë mashkullore. Bazuar në vlerat e testit t, testit F dhe probabilitetet përkatëse, janë evidentuar dallime statistikisht të rëndësishme në katër parametra antropometrikë dhe tri teste motorike ndërmjet djemve nga zonat urbane dhe rurale. Parametrat antropometrikë që matën gjatësinë dhe peshën trupore treguan dallime të sinjifikantë në favor të djemve nga zona urbane, të cilët kanë masa trupore më të mëdha krahasuar me grupin nga zona rurale. Sa i përket aftësive motorike, dallimet u shfaqën në testet e forcës së muskujve të barkut, vrapimit 10x5 metra dhe beep testit në distancën 20 metra. Në testin e forcës së muskujve të barkut dhe në beep test, rezultatet më të mira i shfaqën djemtë nga zona rurale, ndërsa në testin e vrapimit 10x5 metra performanca më e mirë u evidentua te djemtë nga zona urbane.

Tabela 26 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave nëntëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test					
Variablat antropometrike Moshë = 9 vjeçare, Gjinia = Vajza	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference
APT	0.01	0.91	1.33	0.19	2.29
AGJT	0.08	0.77	2.13	0.04	2.92
BMI	1.46	0.23	0.93	0.36	0.70
AGJTU	3.07	0.08	1.14	0.26	15.26
AGJDH	0.15	0.70	0.71	0.48	1.04
AIDHT	4.94	0.03	-1.79	0.08	-1.64
AIDHB	9.41	0.00	-2.53	0.01	-3.64
AIDHSH	1.70	0.19	-1.86	0.07	-1.38
MBF	0.60	0.44	0.01	0.99	0.02
MTD	4.71	0.03	-1.59	0.12	-0.99
MPBU	5.13	0.03	1.68	0.10	3.06
MKV	5.18	0.03	2.89	0.00	11.48
MNPU	12.93	0.00	-2.09	0.04	-2.18
MQVH	0.01	0.92	-0.10	0.92	-0.26
MV10X5	12.81	0.00	2.86	0.01	0.97
MVVA	16.99	0.00	-1.31	0.19	-0.25

Tabela 26 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet vajzave nëntëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale të gjinisë femërore. Bazuar në vlerat e testit t dhe probabilitetet përkatëse, janë evidentuar dallime të rëndësishme në disa parametra. Vajzat nga zonat urbane janë mesatarisht 2.92 centimetra më të gjata krahasuar me vajzat nga zonat rurale. Ndërsa, në indin dhjamor, vajzat nga zonat rurale kanë vlera më të larta të indit dhjamor në pjesën e barkut në krahasim me vajzat urbane. Sa i përket aftësive motorike, në tabelë janë evidentuar tri dallime statistikisht të rëndësishme midis vajzave nga zonat urbane dhe rurale. Në testin e kërcimit së gjati, vajzat nga zona rurale kanë arritur rezultate më të mira (vlera e testit t = 2.89). Në testin e vrapimit 10x5 metra, vajzat nga zona rurale kanë qenë më të shpejta, duke kryer testin mesatarisht 0.97 sekonda më shpejt. Në testin që mat forcën e

muskujve të barkut (përsëritjet në 30 sekonda), vajzat nga zona rurale kanë realizuar mesatarisht 2.18 përsëritje më shumë.

Tabela 27 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrikë dhe motorikë ndërmjet djemve dhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test					
Variablat antropometrike Mosha = 10 vjeçarë, Gjinia = Djem	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Differen ce
APT	12.41	0.00	-4.97	0.00	-9.89
AGJT	0.93	0.34	-0.33	0.74	-0.42
BMI	14.34	0.00	-5.81	0.00	-4.73
AGJTU	0.06	0.80	1.18	0.24	0.94
AGJDH	0.03	0.86	-2.94	0.00	-4.44
AIDHT	18.57	0.00	-2.58	0.01	-3.06
AIDHB	10.49	0.00	-2.70	0.01	-6.98
AIDHSH	11.48	0.00	-2.12	0.04	-3.66
MBF	3.90	0.05	-1.68	0.10	-3.70
MTD	0.77	0.38	-1.44	0.15	-0.71
MPBU	0.59	0.44	-4.08	0.00	-5.90
MKV	0.01	0.94	5.47	0.00	23.44
MNPU	0.32	0.57	-0.94	0.35	-1.02
MQVH	0.24	0.62	0.79	0.43	2.56
MV10X5	5.28	0.02	0.41	0.68	0.12
MVVA	4.16	0.04	0.88	0.38	0.22

Tabela 27 paraqet rezultatet e dallimeve në arritjet antropometrike dhe motorike të djemve dhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale. Bazuar në vlerat e testit t, testit F dhe probabilitetet përkatëse, janë evidentuar dallime statistikisht të rëndësishme në shumicën e përmasave antropometrike, si dhe në testin e fleksibilitetit. Të gjithë parametrat antropometrikë të djemve nga zona rurale janë statistikisht më të lartë krahasuar me ata nga zona urbane. Për shembull, dallimi në mesataren e peshës trupore është veçanërisht i madh, me një diferencë prej 9.89 kilogramësh në favor të

grupit nga zona rurale. Dallime të rëndësishme janë evidentuar gjithashtu në Indeksin e Masës Trupore (BMI) dhe në tri matjet e indit dhjamor nën lëkurë. Ky fenomen paraqet vështirësi për t'u interpretuar, pasi moshë dhjetëvjeçare përfaqëson një periudhë të ndjeshme para pubertetit, ku ndryshimet fiziologjike mund të jenë të konsiderueshme dhe të ndryshme ndërmjet individëve. Në aspektin motorik, djemtë nga të dy zonat nuk kanë treguar dallime të mëdha në shumicën e testeve. Megjithatë, testi i fleksibilitetit të muskujve të ekstremiteteve të poshtme dhe pjesës së trungut ka shfaqur një dallim të theksuar në favor të grupit nga zona rurale (vlera e testit $t = -4.08$). Ndërkohë, në testin e kërcimit së gjati nga vendi, janë evidentuar dallime të rëndësishme në favor të grupit nga zona urbane.

Tabela 28 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave dhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test						
Variablat antropometrike Moshë = 10 vjeçare, Gjinia = Vajza	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means			
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference	
APT	0.83	0.36	-2.00	0.05	-2.99	
AGJT	0.38	0.54	0.50	0.62	0.58	
BMI	6.14	0.01	-2.17	0.03	-1.48	
AGJTU	0.04	0.84	2.74	0.01	1.72	
AGJDH	0.19	0.66	-0.57	0.57	-0.72	
AIDHT	0.86	0.36	-2.02	0.05	-1.48	
AIDHB	2.23	0.14	-2.58	0.01	-4.08	
AIDHSH	0.31	0.58	-0.77	0.44	-0.68	
MBF	1.89	0.17	-1.01	0.31	-1.88	
MTD	13.2	0.00	-4.75	0.00	-2.90	
MPBU	20.1	0.00	-3.18	0.00	-5.54	
MKV	0.68	0.41	7.13	0.00	26.82	
MNPU	0.15	0.70	-2.15	0.03	-2.22	
MQVH	7.64	0.01	-0.60	0.55	-1.15	
MV10X5	1.59	0.21	-0.94	0.35	-0.41	
MVVA	3.31	0.07	-2.48	0.01	-0.42	

Tabela 28 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave dhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale. Bazuar në vlerat e testit t, testit F dhe probabilitetet përkatëse, janë evidentuar dallime statistikisht të rëndësishme në shumicën e parametrave antropometrike mes vajzave nga zonat urbane dhe rurale. Të gjitha vlerat e testit t për përmasat trupore, përfshirë peshën, janë mbi koeficientin 2.00, duke treguar dallime statistikisht të vlefshme në favor të grupit nga zona urbane. Sa i përket testeve motorike, shumica kanë treguar dallime të rëndësishme ndërmjet grupeve. Vajzat nga zona urbane kanë pasur rezultate më të mira në testin e kërcimit së gjati nga vendi (t-test = 7.13) dhe në testin e qëndrueshmërisë (beep test 20 metra; t-test = -2.48). Nga ana tjetër, vajzat nga zona rurale kanë treguar performancë më të mirë në disa teste specifike, si: testi i taping-ut me dorë (p = 0.00), testi i fleksibilitetit të muskujve të ekstremiteteve të poshtme (p = 0.00), dhe testi që mat forcën e muskujve të barkut (p = 0.03).

Tabela 29 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet djemve nëntëmbëdhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale.

Independent Samples Test					
Variablat antropometrike Moshë = 11 vjeçarë, Gjinia = Djem	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference
APT	0.00	0.98	0.68	0.50	1.47
AGJT	0.69	0.41	1.87	0.06	2.40
BMI	0.01	0.91	0.11	0.91	0.09
AGJTU	2.11	0.15	1.71	0.09	1.24
AGJDH	0.00	0.97	0.59	0.55	0.88
AIDHT	9.12	0.00	-0.18	0.85	-0.22
AIDHB	25.14	0.00	-3.02	0.00	-7.58
AIDHSH	13.33	0.00	-1.80	0.08	-2.32
MBF	4.32	0.04	0.90	0.37	1.74
MTD	1.05	0.31	-1.50	0.14	-0.71
MPBU	0.47	0.50	-2.37	0.02	-3.68

MKV	7.17	0.01	2.55	0.01	11.22
MNPU	6.25	0.01	-2.21	0.03	-1.98
MQVH	0.02	0.90	-0.24	0.81	-0.83
MV10X5	2.04	0.16	-0.11	0.91	-0.04
MVVA	6.02	0.02	-2.81	0.01	-0.81

Tabela 29 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike për variablat antropometrike dhe motorike ndërmjet djemve njëmbëdhjetëvjeçarë nga zonat urbane dhe rurale. Bazuar në vlerat e testit t, testit F dhe probabilitetet përkatëse, dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet grupeve janë evidentuar vetëm për matjen e indit dhjamor nën lëkurën e barkut. Këto rezultate tregojnë një variabilitet të lartë brenda grupeve për këtë parametër, duke reflektuar shpërndarje të ndryshme të dhjamatit abdominal. Sa i përket aftësive motorike, janë regjistruar tre dallime statistikisht të vlefshme ($p = 0.01$ deri 0.03). Djemtë nga zona urbane kanë treguar performancë më të mirë në testin e kërcimit së gjati nga vendi (t -test = 2.55), i cili vlerëson forcën eksplozive të gjymtyrëve të poshtme. Ndërkaq, në testin e fleksibilitetit (t -test = -2.37) dhe në testin që mat forcën e muskujve të barkut (t -test = -2.21), rezultatet më të mira janë regjistruar tek djemtë nga zonat rurale. Këto të dhëna sugjerojnë se në moshën njëmbëdhjetëvjeçare, djemtë nga zonat urbane kanë një avantazh në forcën eksplozive, ndërsa ata nga zonat rurale shfaqin rezultate më të mira në fleksibilitet dhe forcë të muskujve abdominalë.

Tabela 30 - Dallimet në variancë dhe mesataret aritmetike të variablave antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave njëmbëdhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale.

Variablat antropometrike Moshë = 11 vjeçare, Gjinia = Vajza	Independent Samples Test				
	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means		
	F	Sig.	t	Sig.	Mean Difference
APT	7.19	0.01	4.84	0.00	8.90
AGJT	1.95	0.17	5.21	0.00	6.84
BMI	12.46	0.00	3.71	0.00	2.50
AGJTU	1.51	0.22	5.89	0.00	4.48
AGJDH	1.38	0.24	2.98	0.00	4.56

AIDHT	7.10	0.01	2.35	0.02	1.98
AIDHB	0.03	0.87	-0.81	0.42	-1.20
AIDHSH	3.01	0.09	0.21	0.83	0.14
MBF	0.20	0.66	0.80	0.43	1.66
MTD	6.56	0.01	-2.51	0.01	-1.18
MPBU	1.01	0.32	-2.26	0.03	-3.64
MKV	1.83	0.18	-2.33	0.02	-9.68
MNPU	0.74	0.39	-2.43	0.02	-2.06
MQVH	1.95	0.17	-0.76	0.45	-1.76
MV10X5	24.32	0.00	-4.22	0.00	-1.09
MVVA	13.32	0.00	-2.89	0.00	-0.65

Tabela 30 paraqet dallimet në variancën dhe mesataret aritmetike për variablat antropometrike dhe motorike ndërmjet vajzave njëmbëdhjetëvjeçare nga zonat urbane dhe rurale. Vlerat e t-testit, F-testit dhe probabilitetet përkatëse tregojnë dallime të konsiderueshme dhe statistikisht të vlefshme në shumicën e parametrave antropometrikë ndërmjet grupeve. Këto dallime sugjerojnë se vajzat nga zonat urbane mund të jenë në një fazë më të hershme të pubertetit – një periudhë në të cilën ndodhin ndryshime të shpejta dhe të dukshme në përmasat trupore. Mesataret e parametrave antropometrikë në grupin urban tregojnë dallime shumë të rëndësishme statistikisht ($p = 0.00$), çka përforcon supozimin për një fazë më të avancuar të maturimit fizik. Në aspektin e aftësive motorike, vajzat nga zonat rurale kanë treguar performancë më të mirë në shumicën e testeve të aplikuara. Përrjashtim bën vetëm testi që mat agjilitetin, në të cilin vajzat nga zonat urbane kanë arritur rezultate më të larta. Ky konfigurim i rezultateve sugjeron se ndryshimet në ndërtimin trupor dhe në fazën e zhvillimit fizik të vajzave urbane mund të kenë ndikuar negativisht në realizimin e detyrave motorike. Rritja trupore e papërfunduar dhe mungesa e stabilitetit fizik gjatë kësaj faze mund të përbëjnë faktorë që ndikojnë në dobësimin e aftësive lëvizore dhe koordinative.

Tabela 31 - Dallimi i variancës së dimensioneve antropometrike të trupit tek nxënësit djem të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.

ANOVA ^a		Sum of	df	Mean	F	Sig.
		Sq.		Square		
APT	Between Groups	1.117	1	1.117	.010	.921
	Within Groups	56229.648	498	112.911		
	Total	56230.765	499			
ALT	Between Groups	443.682	1	443.682	4.589	.033
	Within Groups	48146.868	498	96.680		
	Total	48590.550	499			
BMI	Between Groups	20.467	1	20.467	1.279	.259
	Within Groups	7970.334	498	16.005		
	Total	7990.801	499			
AGJTU	Between Groups	412.232	1	412.232	9.924	.002
	Within Groups	20685.760	498	41.538		
	Total	21097.992	499			
AGJDH	Between Groups	3.200	1	3.200	.028	.866
	Within Groups	56158.408	498	112.768		
	Total	56161.608	499			
AIDHT	Between Groups	33.800	1	33.800	1.299	.255
	Within Groups	12955.368	498	26.015		
	Total	12989.168	499			
AIDHB	Between Groups	2076.722	1	2076.722	18.005	.000

	Within Groups	57440.196	498	115.342		
	Total	59516.918	499			
AIDHSH	Between Groups	252.050	1	252.050	7.110	.008
	Within Groups	17653.028	498	35.448		
	Total	17905.078	499			

a. Gjinia = Djem

Tabela 31 paraqet dallimet në variancën e variablave antropometrikë të djemtë e moshës moshës shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale. Nga gjithsej shtatë masa antropometrike të analizuar, katër prej tyre kanë treguar dallime statistikisht të vlefshme në variancë për grupmoshën e përbashkët 7–11 vjeç. Pesha trupore nuk ka shfaqur dallime të rëndësishme në variancë, as brenda grupeve dhe as ndërmjet zonave urbane dhe rurale, duke sugjeruar një shpërndarje të ngjashme të këtij parametri në të dy mjediset. Nga ana tjetër, gjatësia trupore ka treguar dallime të konsiderueshme në variancë, me një vlerë F-test prej 4.589 dhe $p = 0.033$, duke reflektuar heterogjenitet më të madh në përmasat lineare të trupit ndërmjet grupeve. Po ashtu, gjatësia e trungut ulur ka treguar variancë dukshëm të ndryshme ndërmjet djemve nga zona urbane dhe rurale, me një përqindje probabiliteti prej 0.002, çka e bën këtë parametër veçanërisht të ndryshëm ndaj ndryshimeve mjedisore dhe sociale. Sa i përket përqindjes së indit dhjamor nënlëkuror, matjet në regjionin e barkut dhe të shpinës kanë treguar dallime të theksuara në variancë, me vlerat e F-testit përkatësisht 18.005 dhe 7.110, duke sugjeruar se shpërndarja e dhjavit trupor është dukshëm më e ndryshme si brenda ashtu edhe ndërmjet grupeve nga zonat e ndryshme. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e kontekstit gjeografik dhe ndoshta edhe socio-ekonomik në zhvillimin morfologjik të fëmijëve në këtë periudhë të ndryshme të rritjes.

Tabela 32 - Dallimi i variancës së testeve motorike tek nxënësit djem të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.

ANOVA ^a		Sum of Sq.	df	Mean Square	F	Sig.
MBF	Between Groups	342.792	1	342.792	2.605	.107
	Within Groups	65528.408	498	131.583		
	Total	65871.200	499			
MTD	Between Groups	17.209	1	17.209	1.159	.282
	Within Groups	7391.388	498	14.842		
	Total	7408.597	499			
MPBU	Between Groups	199.712	1	199.712	3.387	.066
	Within Groups	29366.560	498	58.969		
	Total	29566.272	499			
MKV	Between Groups	7104.188	1	7104.188	11.108	.001
	Within Groups	318490.196	498	639.539		
	Total	325594.384	499			
MNPU	Between Groups	92.450	1	92.450	4.214	.041
	Within Groups	10924.788	498	21.937		
	Total	11017.238	499			
MQVH	Between Groups	81.834	1	81.834	.407	.524
	Within Groups	100118.932	498	201.042		
	Total	100200.767	499			
MV10X5	Between Groups	51.476	1	51.476	14.218	.000

	Within Groups	1802.936	498	3.620		
	Total	1854.412	499			
MVVA	Between Groups	6.682	1	6.682	2.415	.121
	Within Groups	1377.748	498	2.767		
	Total	1384.430	499			

a. Gjinia = Djem

Tabela 32 paraqet dallimet në variancën e rezultateve në testet motorike për djemtë e moshës shtatë deri njëmbëdhjetë vjeç nga zonat urbane dhe rurale. Testi i kërcimit së gjati nga vendi ka treguar një variabilitet të rëndësishëm ndërmjet dhe brenda grupeve, me një vlerë të F-testit prej 11.108 dhe probabilitet 0.001, çka tregon një rëndësi shumë të lartë statistikore. Variabilitet i dukshëm është evidentuar gjithashtu në testin që mat forcën e muskujve të barkut në kohëzgjatje prej 30 sekondash, ku grupmoshat kanë shfaqur rezultate të ndryshme gjatë realizimit të testit. Testi me dallimet më të mëdha në variancë është ai i vrapimit 10x5 metra, i cili mat shpejtësinë dhe agjilitetin e lëvizjeve të shpejta. Probabiliteti i këtij testi është 0.000, duke treguar një besueshmëri prej 99.9%, që përfaqëson një rëndësi statistikore jashtëzakonisht të lartë. Në testet e tjera motorike, djemtë nga zonat urbane dhe rurale nuk kanë treguar dallime statistikisht të vlefshme, megjithëse testi i fleksibilitetit ka qenë pranë kufirit të rëndësisë statistikore, me një probabilitet prej 0.066.

Tabela 33 - Dallimi i variancës së dimensioneve antropometrike të trupit tek nxënëset vajza të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.

ANOVA ^a						
		Sum of Sq.	df	Mean Square	F	Sig.
APT	Between Groups	790.200	1	790.200	8.467	.004
	Within Groups	46475.238	498	93.324		
	Total	47265.439	499			
AGJT	Between Groups	1257.698	1	1257.698	11.048	.001

	Within Groups	56690.820	498	113.837		
	Total	57948.518	499			
BMI	Between Groups	43.885	1	43.885	3.397	.066
	Within Groups	6433.146	498	12.918		
	Total	6477.031	499			
AGJTU	Between Groups	2957.312	1	2957.312	3.196	.074
	Within Groups	460774.960	498	925.251		
	Total	463732.272	499			
AGJDH	Between Groups	195.938	1	195.938	1.440	.231
	Within Groups	67774.644	498	136.094		
	Total	67970.582	499			
AIDHT	Between Groups	9.800	1	9.800	.558	.455
	Within Groups	8742.952	498	17.556		
	Total	8752.752	499			
AIDHB	Between Groups	1045.458	1	1045.458	18.766	.000
	Within Groups	27743.764	498	55.710		
	Total	28789.222	499			
AIDHSH	Between Groups	59.168	1	59.168	3.914	.048
	Within Groups	7528.600	498	15.118		
	Total	7587.768	499			

a. Gjinia = Vajza

Tabela 33 paraqet dallimet në variancën e dimensioneve antropometrike të trupit te vajzat nxënëse të shkollave fillore, të moshës shtatë deri njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale. Dallime statistike të rëndësishme në variancë janë evidentuar në katër nga shtatë masat antropometrike të analizuar. Lartësia dhe pesha trupore, si përmasat bazike

antropometrike, kanë shfaqur dallime të konsiderueshme në variancë ndërmjet grupeve. Vlera e F-testit për lartësinë është 11.048 ($p = 0.001$), ndërsa për peshën është 8.467 ($p = 0.004$), çka tregon besueshmëri të lartë statistikore dhe variabilitet të theksuar të këtyre përmasave midis vajzave nga zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu, dy nga matjet që vlerësojnë përçindjen e indit dhjamor nën lëkurë, konkretisht në pjesën e barkut dhe në shpinë, kanë treguar dallime statistikisht të vlefshme si në variancë ndërmjet grupeve, ashtu edhe brenda tyre. Vlerat përkatëse të F-testit janë 18.766 ($p = 0.000$) për barkun dhe 3.914 ($p = 0.048$) për shpinën, duke konfirmuar ndryshime të mëdha në shpërndarjen e këtyre parametrave antropometrikë te vajzat nga zonat urbane dhe rurale.

Tabela 34 - Dallimi i variancës së testeve motorike tek nxënëset vajza të shkollave fillore, në moshën shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, nga zonat urbane dhe rurale.

ANOVA ^a		Sum of Sq.	df	Mean Square	F	Sig.
MBF	Between Groups	177.608	1	177.608	1.649	.200
	Within Groups	53626.184	498	107.683		
	Total	53803.792	499			
MTD	Between Groups	240.499	1	240.499	19.918	.000
	Within Groups	6013.112	498	12.075		
	Total	6253.611	499			
MPBU	Between Groups	49.928	1	49.928	.657	.418
	Within Groups	37830.624	498	75.965		
	Total	37880.552	499			
MKV	Between Groups	7319.138	1	7319.138	15.741	.000
	Within Groups	231563.812	498	464.988		
	Total	238882.950	499			

MNPU	Between Groups	125.000	1	125.000	5.373	.021
	Within Groups	11585.672	498	23.264		
	Total	11710.672	499			
MQVH	Between Groups	49.487	1	49.487	.377	.539
	Within Groups	65357.835	498	131.241		
	Total	65407.322	499			
MV10X5	Between Groups	.541	1	.541	.137	.711
	Within Groups	1966.624	498	3.949		
	Total	1967.165	499			
MVVA	Between Groups	13.252	1	13.252	3.971	.047
	Within Groups	1662.063	498	3.337		
	Total	1675.315	499			

a. Gjinia = Vajza

Tabela 34 paraqet dallimet në variancën e realizimit të detyrave motorike te vajzat e moshës shtatë deri njëmbëdhjetë vjeç nga zonat urbane dhe rurale. Testi i tapingut me dorë ka shfaqur dallimin më të madh statistikisht të rëndësishëm në variancë, me një vlerë të F-testit prej 19.918 dhe probabilitet $p = 0.000$, që tregon një ndryshim shumë domethënës në shpërndarjen e rezultateve ndërmjet dhe brenda grupeve të krahasuara. Po ashtu, testi i kërcimit së gjati nga vendi, i cili vlerëson forcën eksplozive të gjymtyrëve të poshtme, ka treguar një variabilitet të konsiderueshëm, me $F\text{-test} = 15.741$ dhe $p = 0.000$, duke reflektuar ndryshime statistikisht të vlefshme në performancën motorike ndërmjet grupeve. Variabilitet i theksuar është evidentuar edhe në testin e qëndrueshmërisë kardiorespiratore (testi i vrapimit në vijë të drejtë – beep test 20 metra), ku $F\text{-test} = 3.971$ tregon një ndryshim të konsiderueshëm në rezultatet e vajzave nga grupet urbane dhe rurale. Gjithashtu, testi që mat forcën e muskujve të barkut ka treguar dallime në variancë, me vlerën e F-testit 5.373, duke reflektuar ndryshime të ndjeshme në shpërndarjen e performancës në këtë komponent motorik. Në testet e tjera motorike të përfshira në analizë, nuk janë evidentuar dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet vajzave nga zonat urbane dhe ato rurale.

9. VERTETIMI I HIPOTEZAVE

Pas përpunimit, interpretimit dhe analizës së rezultateve të këtij hulumtimi, mund të konstatojmë se objektivat e parashtruara në fillim të punimit nuk janë realizuar plotësisht.

Vërtetimi i hipotezave të parashtruara është si vijon:

H1: Hipoteza e parë, sipas së cilës mund të ketë dallime statistikore të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit të nxënësve të shkollave fillore, moshë 7-11 vjeçar, djemve nga zonat urbane dhe rurale, është vërtetuar pjesërisht.

Dallime statistikisht të vlefshme janë vërejtur tek lartësia e trupit, me vlerën e F-testit 4.589 dhe probabilitet .033. Kjo pasqyron dallime të theksuara ndërmjet dhe brenda grupeve të moshave për djemtë nga zonat urbane dhe rurale.

Gjatësia e trungut ulur është masa tjetër antropometrike që dallon statistikisht variancën e grupeve të të rinjve nga zonat urbane dhe rurale, me probabilitet .002.

Indi dhjamor nën lëkuror në bark dhe në shpinë te grupmoshat 7-11 vjeçar ka treguar dallime të mëdha variabile ndërmjet dhe brenda grupeve, me vlera të F-testit përkatësisht 18.005 dhe 7.110.

H2: Hipoteza e dytë, që parashikon dallime statistikore të rëndësishme në dimensionet antropometrike të trupit të nxënësve të shkollave fillore, moshë 7-11 vjeçar, nga zonat urbane dhe rurale, është vërtetuar gjithashtu pjesërisht.

Dallimet në variancën e variablave antropometrikë për vajzat e kësaj moshe janë paraqitur në tabelën 33, ku katër prej shtatë masave kanë ndryshime statistikisht të rëndësishme.

Lartësia e trupit dhe pesha trupore, si masa bazike të matjeve antropometrike, kanë dallime të theksuara në variancë. Vlerat e F-testit janë 8.467 për peshën dhe 11.048 për lartësinë e trupit, me probabilitete përkatëse .004 dhe .001.

Gjithashtu, dy masat që matin indin dhjamor nën lëkuror në bark dhe në shpinë kanë vlefshmëri statistikore të lartë, si rezultat i dallimeve të theksuara ndërmjet dhe brenda grupeve të vajzave nga zonat urbane dhe rurale. Vlerat e F-testit për këto masa janë 18.766 dhe 3.914, me probabilitet .000 dhe .048.

H3: Hipoteza e tretë, sipas së cilës do të ketë dallime statistikore të rëndësishme në aftësitë motorike të nxënësve djem të shkollave fillore, moshë 7-11 vjeçar, nga zonat urbane dhe rurale, është vërtetuar pjesërisht. Testi i kërcimit së gjati nga vendi ka treguar variabilitet të rëndësishëm ndërmjet dhe brenda grupeve, me vlerë të F-testit 11.108 dhe probabilitet .001, që tregon rëndësi të lartë statistikore.

Variabilitet i dukshëm është shfaqur edhe në testin që vlerëson muskujt e barkut në kohëzgjatje prej 30 sekondash, ku grupmoshat kanë dhënë rezultate të ndryshme gjatë realizimit të testit.

Dallime më të mëdha në variancë ka pasur testi i vrapimit 10x5 m, që mat shpejtësinë dhe agjilitetin e lëvizjeve të shpejta, me probabilitet .000, që është në kufi të besueshmërisë 99.9%.

Në testet e tjera motorike, nuk janë vërejtur dallime statistikisht të vlefshme ndërmjet të rinjve nga zonat urbane dhe rurale, megjithëse testi i fleksibilitetit ishte në kufi të vlefshmërisë statistike me probabilitet .066.

H4: Hipoteza e katërt, sipas së cilës do të ketë dallime statistikore të rëndësishme në aftësitë motorike të nxënësve të shkollave fillore, moshë 7-11 vjeçar, vajzat nga zonat urbane dhe rurale, është vërtetuar pjesërisht. Testi i tappingut me dorë ka shfaqur dallimin më të madh statistikor në variancë, me vlerë F-testit 19.918 dhe probabilitet .000.

Po ashtu, testi i kërcimit së gjati nga vendi ka treguar variabilitet të lartë ndërmjet dhe brenda grupeve, me vlerë F-testit 15.741 dhe probabilitet .000, duke pasqyruar rëndësi të lartë statistikore.

Variabilitet i dukshëm është vërejtur edhe në testin që mat qëndrueshmërinë në vrapimin beep 20 m, me vlerë F-testit 3.971.

Gjithashtu, testi që mat forcën e muskujve të barkut ka shfaqur dallime në variancë, me vlerë F-testit 5.373.

Në testet e tjera motorike nuk janë vërejtur ndryshime statistikisht të rëndësishme ndërmjet vajzave nga zonat urbane dhe rurale.

10. DSKUTIMI

Tashmë është vënë re se të rinjtë nga zonat rurale kanë nivele përgjithësisht më të larta të fitnesit krahasuar me homologët e tyre nga zonat urbane (Chillón, Ortega, Ferrando & Casajus, 2011). Fëmijët nga zonat rurale shpesh angazhohen në më shumë aktivitete fizike gjatë gjithë ditës, përfshirë lojëra në natyrë, ndihmë në punë fizike me prindërit dhe disponojnë një hapësirë më të gjerë për lëvizje. Një raport nga Spanja konfirmoi se pjesëmarrësit nga zonat rurale kishin nivele më të larta të pjesëmarrjes në sporte të organizuara sesa ata nga zonat urbane (Chillón et al., 2011).

Një studim i ngjashëm (Chasan, Toksöz & Sut, 2010) është realizuar më parë në Turqi me nxënës të moshës 8-11 vjeçar nga dy mjedise të ndryshme, por pa stratifikim sipas moshës. Autorët gjetën se dallimet më të vogla mes nxënësve, në varësi të moshës, ishin në BMI, testet e flamingos, plate toping, kërcim së gjati, dinamometri dhe testet e vrapimit 10x5 m. Ndërsa lartësia, pesha, muskujt e barkut në 30 sekonda dhe testi i qëndrimit të varur në hekur treguan dallime të rëndësishme midis djemve nga shkolla dhe mjedise të ndryshme, ku vetëm i fundit favorizonte mjedisin e fundit.

Në hulumtimin tonë në Kosovë, për grupmoshën 7-11 vjeçar, nga 7 masat antropometrike të djemtë, 4 treguan dallime statistikisht të rëndësishme midis zonave urbane dhe rurale. Pësia e trupit nuk shfaqti dallime të rëndësishme në variancë ndërmjet dhe brenda grupeve. Dallime të dukshme u identifikuan të lartësia e trupit, me vlerën e F-testit 4.589 dhe probabilitet .033. Kjo tregon për dallime të theksuara ndërmjet dhe brenda grupeve për djemtë nga zonat urbane dhe rurale. Gjatësia e trungut të ulur gjithashtu dallon në mënyrë statistikisht të rëndësishme me probabilitet .002. Indeksi i indit dhjamor nën lëkuror në bark dhe shpinë për grupmoshën 7-11 vjeçar tregon dallime të mëdha në variancë, me vlera F-testi përkatësisht 18.005 dhe 7.110.

Në anën tjetër, variancat të masat antropometrike për vajzat 7-11 vjeçar nga zonat urbane dhe rurale, paraqiten në Tabelën 33. Variancat janë statistikisht të ndryshme në 4 nga 7 masat antropometrike. Lartësia dhe pesha e trupit, si matje bazë antropometrike, kanë dallime të rëndësishme në variancë. Vlerat e F-testit për peshën dhe lartësinë janë 8.467 dhe 11.048, me probabilitet statistikor përkatësisht .004 dhe .001. Po ashtu, masat që matin indin dhjamor nën lëkuror në bark dhe shpinë kanë vlefshmëri statistikore të dukshme, me vlera F-testesh 18.766 dhe 3.914 dhe probabilitet .000 dhe .048.

Ky studim ofron një pasqyrë më të qartë të ndryshimeve ndërgjeneruese mes fëmijëve, djemve dhe vajzave në mjedise të ndryshme. Fëmijët nga

zonat urbane janë zakonisht më të mëdhenj, më të rënda dhe më të gjatë, ndoshta për shkak të qasjes më të lehtë në ushqime të ndryshme, të përpunuara dhe jo të përpunuara, që ndikojnë në rritjen e tyre. Ata gjithashtu tregojnë një forcë më të madhe në këto moshë, gjë që mund të shpjegohet me pjesëmarrjen më të shpeshtë në aktivitete të organizuara nën mbikëqyrje profesionale, si dhe ndryshimet në dietë. Nga ana tjetër, djemtë nga zonat rurale duket të hyjnë më herët në fazën e para pubertetit, ndoshta si pasojë e aktivitetit fizik më intensiv në natyrë, ndërsa djemtë nga zonat urbane kanë tendencë të zhvillojnë një stil jetese më sedentare gjatë rritjes, shpesh të ndikuar nga përdorimi i pakontrolluar i videoljërave dhe internetit.

Rezultatet tregojnë një efekt të dukshëm të para pubertetit tek djemtë, të cilët tregojnë kapacitete më të mira në variabla që lidhen me forcën, megjithëse nuk ka ndryshime në dimensionet trupore midis djemve dhe vajzave. Testosteroni, hormoni kryesor për performancën sportive, ka një ndikim të rëndësishëm në forcë, fuqinë, konkurrencën dhe agresivitetin, si një mekanizëm i trashëguar (Babić, 2023). Kjo mund të shpjegojë performancën më të mirë të djemve në forca dhe shpejtësi. Për vajzat, estrogeni mund të ketë ndikim disavantazhues në performancën fizike gjatë periudhës së aktivitetit intensiv. Trendi i rritjes së dimensioneve trupore shpesh shoqërohet me stabilizim ose edhe ulje të kapaciteteve fizike (Wilczewski et al., 1996).

Tabela 32 paraqet dallimet në variancë të detyrave motorike për djemtë 7-11 vjeçar nga zonat urbane dhe rurale. Kërcimi së gjati nga vendi shfaqti një variabilitet të rëndësishëm me vlerën e F-testit 11.108 dhe probabilitet .001, që tregon rëndësi të lartë statistikore. Dallime në variancë janë shfaqur edhe në testin e muskujve të barkut në 30 sekonda. Testi i vrapimit 10x5m, që mat shpejtësinë dhe agjilitetin, kishte dallime të mëdha në variancë me probabilitet .000, duke treguar besueshmëri prej 99.9%. Në testet e tjera lëvizore, dallimet midis grupeve nuk ishin statistikisht të rëndësishme, përveç testit të fleksibilitetit që ishte në kufi me probabilitet .066.

Tabela 34 paraqet dallimet në detyrat motorike për vajzat 7-11 vjeçare nga zonat urbane dhe rurale. Tapingu me dorë shfaqti dallimin më të madh statistik, me vlerë 19.918 dhe probabilitet .000. Kërcimi së gjati nga vendi tregoi gjithashtu variabilitet të rëndësishëm me F-test 15.741 dhe probabilitet .000. Testi i qëndrueshmërisë në vrapim beep 20m shfaqti dallime më të vogla, me vlerën e F-testit 3.971. Testi i forcës së muskujve të barkut tregoi dallime të rëndësishme me vlerë 5.373. Në testet e tjera motorike, vajzat nuk treguan rezultate statistikisht të rëndësishme midis zoneve.

Në përfundim, vërehet një rritje e dukshme e aftësive kardiorespiratore në të dyja gjinitë gjatë rritjes. Kjo lidhet kryesisht me ndryshimet morfologjike që ndodhin me moshën dhe hyrjen në pubertet. Rritja e masës skeletore dhe muskulore përmirëson furnizimin maksimal me oksigjen, gjë që rrit qëndrueshmërinë dhe performancën sportive (Jakovljević, Bošnjak, Pašić & Tešanović, 2022).

11. KONKLUDIMI

Ky studim monografik përfaqëson, pa dyshim, një ndër të parët që trajton në mënyrë të shtresuar sipas moshës dallimet midis fëmijëve nga zonat rurale dhe urbane në rritje dhe aftësitë motorike. Rezultatet tregojnë se në fillim, fëmijët nga zonat urbane kanë një avantazh për shkak të qasjes më të gjerë në aktivitete fizike të organizuara dhe dieta më të ndryshme - përfshirë edhe ushqimet që, megjithëse shpesh më pak të shëndetshme, mund të kontribuojnë në rritjen e fuqisë fizike. Megjithatë, me kalimin e kohës, mjedisi rural duket të ofrojë një ndikim më të shëndetshëm në rritjen dhe zhvillimin e aftësive motorike të djemtë.

Nga kjo del që është shumë e rëndësishme që fëmijët nga zonat urbane të vazhdojnë të jenë aktivë në mënyrë të organizuar gjatë gjithë periudhës së shkollës, në mënyrë që të ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë motorike dhe funksionale në nivel të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat rurale.

Gjithashtu, tiparet morfologjike midis grupeve ruralë dhe urbanë po afrohen gradualisht të faza para-pubertetit, duke treguar një barazim në zhvillim.

Kufizimi kryesor i këtij studimi qëndron në përzgjedhjen e mostrat, e cila përfshin vetëm disa qytete të Kosovës (Prishtinë, Vushtri, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe një numër relativisht të kufizuar pjesëmarrësish. Studimet e ardhshme do të ishin të dobishme nëse do të zgjerojnë hulumtimin në të gjitha qytetet e Kosovës, si dhe në vende të ndryshme evropiane dhe globale, për të ofruar një pasqyrë më të gjerë dhe më të thelluar mbi ndikimet e mjedisit urban dhe rural në zhvillimin e fëmijëve.

12. LITERATURA

- ACSM. (2018). *U.S. Department of Health and Human Services. Physical Activity Guidelines for Americans, 2nd edition. Washington, DC: U.S. U.S.*
- Adam, C. K. (1988). European Test of Physical Fitness Council of Europe. Committee for the Development of Sport Rome.
- Babić, M. P. (2023). Physiological response and biomarkers in kickboxing - systematic review. *Physical Activity Review*, 11 (2), 120-137. doi:doi: 10.16926/par.2023.11.27
- Biddle, S. S. (1998). *Young and active? Young people and health-enhancing physical activity: evidence and implications*. London:: Health Education.
- C, A., Klissouras V, Ravazzolo M, Renson R, & Tuxworth W. (1988). Eurofit: European Test of Physical Fitness. *Council of Europe, Committee for the Development of Sports*.
- CHASAN, K., TOKSÖZ, İ., & SUT, N. (2010). Physical Condition Evaluation of Students Between 8-11 Years of Age by Eurofit Tests. *Spor Hekimliği Dergisi*, 45(1), 025-034. Retrieved from <https://journalofsportsmedicine.org/full-text/97/eng>
- Chillón, P., Ortega, F. B., Jose Antonio Ferrando, & Jose Antonio Casajus. (2011). Physical fitness in rural and urban children and adolescents from Spain. *Journal of Science and Medicine in Sport*, 14(5), 417-423. doi:10.1016/j.jsams.2011.04.004
- Dencker, M., & Andersen, L. B. (2008, February 03). Health-related aspects of objectively measured daily physical activity in children. 133-144. Retrieved from <https://doi.org/10.1111/j.1475-097X.2008.00788.x>
- Jakovljević, V., Bošnjak, G., Pašić, G., & Tešanović, G. (2022). Roll of Somatotype in Sport selection. 1. doi:10.51371/issn.1840-2976.2022.16.1.11

- Madic, D. (2000). *Povezanost antropoloških dimenzija studenata fizicke kulture sa njihovom uspešnošću vežbanja na spravama*. Novi Sad: Fakultet fizicke kulture: Doktorska disertacija.
- Myers, J., Prakash, M., Froelicher, V., Do, D., Partington, S., & Atwood, J. E. (2002, Mars). Exercise capacity and mortality among men referred for exercise testing. *N Engl J Med*, 793-801. doi:10.1056/NEJMoa011858
- Popović, B. (2008). *Trend razvoja antropometrijskih karakterisika dece uzrasta 4-11 godina*. Glasnik antropološkog društva. Retrieved from <https://scindeks.ceon.rs/article.aspx?artid=1820-79360843455P>
- Wilczewski, A., Sklad, M., Krawczyk, B., Saczuk, J., & Majle, B. (1996). Physical development and fitness of children from urban and rural areas as determined by EUROFIT test battery. *Biology of Sport*, 13, 113-126.

Autorët:

Prof. Asst. Dr. Besnik Morina & Prof. Asst. Dr. Florian Miftari

Titulli:

Analizë krahasuese e zhvillimit motorik dhe antropometrik tek fëmijët
shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç

Lektor:

Dr. Sc. Gani Ibrahimimi

Korrektor:

Dr. Sc. Gani Ibrahimimi

Redaktor artistik:

Shaban Ukshini

Realizues kompjuterik:

Shaban Ukshini

Autor i ilustrimeve:

Shaban Ukshini

Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen me ligj.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

612.76-053.5(048.8)

796.012-053.5(048.8)

Morina, Besnik

Analizë krahasuese e zhvillimit motorik dhe antropometrik tek fëmijët shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç : (monografi) / Besnik Morina, Florian Miftari. - Prishtinë : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2025. - 75 f. : ilustr. ; 25 cm.

1. Miftari, Florian

ISBN 978-9951-00-375-9